



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

V E N D I M

Nr. 2486, datë 26.06.2014

Për

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. në lidhje tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Antëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 26.06.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimi i procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. në lidhje tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (K.Pr.A);
3. Rregulloren nr. 18, datë 11.6.2010 “Për procedurat e zgjidhje së mosmarrëveshjeve”;

4. Rregullore nr. 19, datë 14.6.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar;

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresë e Nisatel sh.p.k, me nr. 101/1Prot. datë 27.5.2014, “Mbi tarifën e terminimit të trafikut ndërkombëtar në rrjetin e Nisatel sh.p.k.”;
- Korrespondenca në formë elektronike e shkëmbyer me AKEP.
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*),

si dhe duke i`u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Me anë të kësaj shkrese Nisatel sh.p.k. na informon në lidhje me mosmarrëveshjen e lindur me Albtelcom sh.a. sa i takon tarifës së thirrjeve të trafikut ndërkombëtar të terminuara nga Albtelcom në Nisatel sh.p.k. si thirrje të tarifuara me cmimin e trafikut kombëtar.

Nisatel shprehet se janë shkelur e detyrimet e Marrëveshjes së Interkoneksionit (MI) së lidhur mes palëve, dhe kjo ka çuar në mospagim të këtyre faturave nga ana e Albtelcom duke e çuar Nisatel në vështirësi financiare. Faturat nuk janë paguar për muajt Shkurt, Mars, Prill 2014 dhe vlera e tyre është 921579 Lekë.

Nisatel shprehet se i ka kërkuar Albtelcom-it disa herë të negociojë, por ky i fundit pretendon se çmimi i vendosur në MI dypalëshe, anekset e saj dhe njoftimet midis tyre duhet të jenë ndryshe. Ky cmim i pretenduar nga Albtelcom, është 12 herë më i ulët se çmimi aktual. Pretendimi i Albtelcom është se teknikisht nuk rregullon dot rrugëzimin e numrave të portuar nga rrjeti Albtelcom tek rrjeti i Nisatel. Si rrjedhim Albtelcom kërkon që për muajin mars një shërbim të cilin duhet ta paguajë 18 lekë/min, ta paguajë për 1.5 lekë/min. Nga këto diferenca, Nisatel-it i shkaktohet një humbje financiare për muajt Prill dhe Maj me vlerë prej 619147 Lekë.

Nisatel shpjegon se kjo gjendje po sjell anomali dhe Nisatel nuk mund të ndërpresë komunikimin e thirrjeve ndërkombëtare të abonentëve të vet që kanë numra të portuar, duke refuzuar thirrjet nga Albtelcom, i cili duhet të kishte marrë masa për ta zgjidhur teknikisht këtë çështje.

Nisatel shpjegon se, Albtelcom vazhdon të zvarrisë dhe të ndryshojë vlerat e faturave në kundërshtim me MI lidhur mes palëve, duke bërë që situata sa vjen e të rëndohet.

Nisatel shprehet se nga ana e Albtelcom është pretenduar se ka kërkuar nga AKEP rregullimi i thirrjeve ndërkombëtare.

Nisatel shpjegon se balanca e numrave të portuar midis Nisatel dhe Albtelecom është 400 numra të portuar nga Albelecom në Nisatel dhe 4 numra të portuar nga Nisatel në Albtelecom, shifra këto në rritje, dhe Albtelecom është i interesuar të abuzojë sa më shumë me çmime monopol në dëm të Nisatel.

Nisatel shpjegon se ka patur tentativa duke përfshirë edhe komunikimin telefonik, e-mail dhe komunikim shkresor, duke kërkuar shpjegime nga ana e Albtelecom. Këto veprime të kryera nga Albtelecom janë në kundërshtim me:

- Marrëveshjen e Interkoneksionit nr. 2929Prot. datë 24.6.2014, neni 27 – Shkelja, pezullimi dhe zgjidhja e marrëveshjes së interkoneksionit;
- Rregulloren nr. 18, datë 11.6.2010 “Për procedurat e zgjidhje së mosmarrëveshjeve”;
- Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Sa më lart, Nisatel sh.p.k. i kërkon AKEP të fillojë procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelcom sh.a.

Gjithashtu këtë shqetësim Nisatel e thekson edhe në shkresën me nr. 101/1Prot, datë 27.5.2014, drejtuar në AKEP e për dijeni Autoritetit të Konkurrencës.

AKEP, konstaton se njoftimi me shkrim për mosmarrëveshjen nga Nisatel sh.p.k., përmban informacionin e kërkuar të përshkruar në Shtojcën I të “Rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve”, dhe konsiderohet se përmbush kushtet ligjore për pranimin e kërkesës dhe shqyrtimin e mosmarrëveshjes nga AKEP-i duke proceduar administrativisht, sipas procedurës së parashikuar në nenin 120 të ligjit nr. 9918 të ndryshuar dhe Rregullores nr. 18/2010.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, nenin 46 e vijues të K.Pr.A,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Nuredin Hasanaj Anëtar

- Esmeralda Dervishi Anëtar
- Afërdita Gjongecaj Anëtar

1. Të njoftohen palët e interesuara Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;
2. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**